

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

Njoftim për vend pune

Përkthyes/Asistent zyre (angazhim me kohë të pjesshme) i Liderit të Komponentit për mbrojtjen e të drejtave themelore për kontratën e grantit “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit”

Punëdhënës: Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut

Lokacioni: Shkup, Maqedonia e Veriut

Lloji: angazhim me kohë të pjesshme (50%)

Data e pritur e fillimit: 20.9.2022

Kohëzgjatja e pritur: tetëmbëdhjetë muaj, shtator 2022 – janar 2024

HISTORIA

Projekti “Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit” është projekt i financuar nga BE i zbatuar nga Agjencia Austriake për Integrim European dhe Zhvillim Ekonomik (AEI), Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut. Objektivi i përgjithshëm i projektit është forcimi i sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht:

- (1) të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të drejtësisë për të dhënë drejtësi në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme;
- (2) të forcojë kapacitetet për të zbatuar në mënyrë efektive teknikat moderne të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar;
- (3) për të përmirësuar parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit;
- (4) për të rritur mbrojtjen e të drejtave themelore dhe për të forcuar përdorimin e mjeteve alternative të paraburgimit.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

- Mbështetje Liderit të Komponentit (Komponenti 4: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave themelore dhe përdorimi më i fortë i mjeteve alternative të paraburgimit) në detyrat e tij të përditshme. Ofron shërbime të menaxhimit të zyrës, organizon punëtori dhe seminare trajnimi dhe ofron ndihmë për ekipin e ekspertëve në çështjet organizative dhe administrative që kanë të bëjnë me punën e tyre në Maqedoninë e Veriut.
- Përkthim nga anglishtja në maqedonisht dhe anasjelltas, në takime dhe biseda të tjera gojarisht.
- Përkthim i dokumenteve, rregulloreve, materialeve të trajnimit, materiale informative dhe materiale të tjera të shkruara nga maqedonishtja në anglisht dhe nga anglishtja në maqedonisht.

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

- Përpilimi i materialeve me shkrim në lidhje me projektin në gjuhën maqedonase dhe angleze.

KUALIFIKIMET E NEVOJSHME

- Rrjedhshmëri profesionale me gojë dhe me shkrim në anglisht dhe maqedonisht; njohja e mire e shqipes do të ishte avantazh
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe aftësi për rrjetëzim
- Aftësi shumë të mira organizative dhe administruese në zyrë
- Stili i punës autonome, i organizuar dhe i zellshëm, me një sens të mirë për prioritetet
- Njohuri bazë për situatën politike, ligjore dhe administrative në Maqedoninë e Veriut dhe për institucionet dhe politikat e BE-së.
- Interesim i vërtetë për çështjet e të drejtave të njeriut
- Aftësi shumë të mira kompjuterike (MS Office, Word, Excel, Internet)
- Aftësi të mira për të menaxhuar mjedisin multikulturor
- Ai/ajo duhet të jetë në gjendje të veprojë me maturi dhe të ketë aftësi të mira prezantuese dhe sjellje të shkëlqyera.

KONTRATA DHE SHPËRBLIMI

Kontrata do të mbulojë shërbimet për 18 muaj gjatë zbatimit të projektit.

Asistenti i përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë ofruesi shërbimi me Institutin Ludwig Boltzmann për të Drejtat Themelore dhe të Njeriut (gmr.lbg.ac.at) dhe duhet të ketë statusin e të vetëpunësuarit. Do të jetë përgjegjësia e tij/saj e vetme që të respektojë të gjitha kërkesat ligjore për vetëpunësim si dhe të mbulojë të gjitha taksat dhe tarifat përkatëse.

Pagesa e shpërblimit do të bëhet sipas kontratës së grantit.

DORËZIMI I APLIAKACIONEVE

Aplikacionet duhet të dërgohen deri te dieter.schindlauer@rol.mk deri më 07.09.2022, duke shënuar "Translator/Office Assistant Component 4" në titullin e e-mailit (subject) dhe duke përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për një intervistë personale.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM

Përkthyesi/asistenti i zyrës nuk duhet të ketë pasur kontratë pune me administratën publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku 6 muaj para punësimit.